



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 584 Akti

Nr. 552 Vendimi

Tiranë, më 14.7.2022

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Lulzim Hamitaj	Kryesues
Genta Tafa (Bungo)	Relatore
Valbona Sanxhaktari	Anëtare

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Etmonda Hoxha, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Gerrit Sprenger, në datën 12.7.2021, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, zhvilloi seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Riselda Fishta**, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2015, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Genta Tafa (Bungo), vlerësoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe analizoi provat shkresore të

paraqitura në vijim të rezultateve të hetimit dhe në seancë dëgjimore, si dhe shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është institucioni që kryen procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, bazuar në paragrafin 5 të nenit 179/b të ligjit nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, në pikën 5 të nenit 3 dhe në pikën 1 të nenit 5 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

2. Subjekti i rivlerësimit, znj. Riselda Fishta, aktualisht me detyrë prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, është subjekt i rivlerësimit, që i nënshtrohet rivlerësimit *ex officio*, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

3. Bazuar në pikën 2 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni) ka hedhur shortin në datën 15.6.2020, nga i cili rezultoi se subjekti i rivlerësimit, znj. Riselda Fishta, do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Genta Tafa (Bungo), Lulzim Hamitaj dhe Valbona Sanxhaktari. Relatore e çështjes u zgjodh me short komisionere Genta Tafa (Bungo).

4. Në mbledhjen e trupit gjykues të datës 17.6.2020 u caktua me mirëkuptim kryesues z. Lulzim Hamitaj, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin Riselda Fishta.

5. Në referim të pikës 1 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, për subjektin e rivlerësimit, znj. Riselda Fishta, nisi procesi i rivlerësimit dhe hetimi i thelluar administrativ.

6. Proces i vlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun IV, “Vlerësimi i pasurisë”, të ligjit nr. 84/2016, dhe veçanërisht në nenin 30 të këtij ligji, ka për objekt të vlerësimit deklarin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur të tij.

7. Proces i vlerësimit të kontrollit të figurës, në përputhje me kreun V, “Kontrolli i figurës”, të ligjit nr. 84/2016, dhe veçanërisht në nenin 34 të këtij ligji, ka për objekt verifikimin e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin nëse subjekti ka/ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të përcaktuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

8. Proces i vlerësimit të aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun VI, “Vlerësimi i aftësive profesionale”, të ligjit nr. 84/2016, ka për objekt vlerësimin e veprimtarisë etike dhe profesionale të subjektit të rivlerësimit, në përputhje me ligjin nr. 84/2016 dhe me legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve.

9. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë

i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK); dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë. Këto raporte janë administruar nga relatori me fillimin e hetimit administrativ.

10. Në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, Inspektoratit i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave dërgoi raportin¹ e hollësishëm dhe të arsyetuar pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, znj. Riselda Fishta. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja për secilën pasuri dhe të ardhur të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit, është konstatuar se:

- a) *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- b) *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- c) *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- d) *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- e) *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

11. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja ka dërguar raportin² për subjektin e rivlerësimit, në përfundim të të cilit ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, znj. Riselda Fishta.

12. Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016 dhe të pesë dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe ka dërguar, në zbatim të nenit 43 të ligjit nr. 84/2016, një raport³ të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit.

13. Në vijim, relatori i çështjes ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016, duke kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm mbi të tria kriteret: të vlerësimit të pasurisë; të kontrollit të figurës; dhe të vlerësimit të aftësive profesionale.

14. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe provat e grumbulluara për kriterin e vlerësimit të pasurisë, të kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, në datën 22.6.2021 vendosi përfundimin e hetimit kryesisht për të tria kriteret për subjektin e rivlerësimit, znj. Riselda Fishta, si dhe njoftimin e subjektit për t'u njohur me materialet e dosjes dhe rezultatet e hetimit në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative.

15. Subjekti i rivlerësimit u njoftua mbi të drejtën e saj për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë apo të kërkonte marrjen e provave të reja ose thirrjen e dëshmitarëve, lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga Komisioni me anë të postës elektronike të datës 22.6.2021. Subjekti i rivlerësimit, në datën 7.7.2021,

¹ Me shkresën nr. *** prot., datë 9.1.2018.

² Raporti nr. *** prot., datë 27.10.2017, deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. *** , datë 6.1.2021, të KDZH-së.

³ Me shkresën nr. *** prot., datë 14.4.2021.

dërgoi nëpërmjet postës elektronike parashtrime në lidhje me rezultatet e hetimit, si dhe paraqiti prova dhe dokumentacion mbështetës.

16. Pas administrimit të parashtrimeve të subjektit, provave dhe dokumentacionit, trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore⁴.

II. SEANCA DËGJIMORE

17. Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancën dëgjimore publike me njoftimin e bërë elektronikisht me *e-mail*, në datën 8.7.2021.

17.1. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në datën 12.7.2021, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Gerrit Sprenger.

17.2. Subjekti i rivlerësimit, znj. Riselda Fishta, mori të gjithë kohën e kërkuar për të shprehur dhe parashtruar shpjegimet dhe opinionin individual në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer ndaj saj. Në përfundim të shpjegimeve dhe parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit kërkoi nga Komisioni konfirmimin në detyrë.

17.3. Në përfundim të seancës së datës 12.7.2021, trupi gjykues, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të nenit 58, pika 1, germa “b”, nenit 44/b, si dhe të nenit 60, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, vendosi: *“Pezullimin nga detyra për një periudhë 1-vjeçare të subjektit të rivlerësimit Riselda Fishta, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë dhe detyrimin e saj për të ndjekur programin e trajnimit, sipas kurrikulave të miratuara nga Shkolla e Magjistraturës”*.

17.4. Me shkresën nr. *** prot., datë 10.9.2021, vendimi i Komisionit iu dërgua Shkollës së Magjistraturës me qëllim përgatitjen e programit të trajnimit për subjektin e rivlerësimit.

17.5. Me shkresën nr. *** prot., datë 1.7.2022, të Shkollës së Magjistraturës, Komisioni është njoftuar për rezultatet e provimit përfundimtar dhe se subjekti i rivlerësimit ka përfunduar me sukses programin e trajnimit, duke mënjanuar mangësitë e konstatuara nga hetimi administrativ.

17.6. Pas administrimit të këtyre rezultateve, trupi gjykues, i mbledhur në dhomë këshillimi, diskutoi, vlerësoi dhe vendosi të konsiderojë të përfunduar procesin e rivlerësimit për subjektin Riselda Fishta.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

18. Znj. Riselda Fishta ka qenë bashkëpunuese në procesin e rivlerësimit të kryer ndaj saj, duke u përgjigjur në kohë, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ.

18.1. Subjekti i rivlerësimit ka sjellë prova dhe shpjegime, kur janë nevojitur, ka qenë korrekte dhe e gatshme për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancave dëgjimore.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

19. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së

⁴ Vendimi i ndërmjetëm nr. 3, datë 8.7.2021.

Shqipërisë, Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

19.1. Referuar vendimit nr. 2/2017⁵ të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016 rezulton se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

19.2. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga vetë subjekti në ILDKPKI me “Deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*”; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) “Deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting*”, të dorëzuar nga subjekti në ILDKPKI; (ç) deklaratat periodike të dorëzuara ndër vite dhe provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja, të cilat gjenden në dosjen e subjektit, dërguar në Komision; (d) provat shkresore/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (dh) raportet e kontrollit të figurës të dorëzuar pranë Komisionit nga DSIK-ja; (e) raportin e analizimit të aftësive profesionale të dorëzuar pranë Komisionit nga KLP-ja; (ë) denoncimet e publikut; si dhe (f) shpjegimet me shkrim dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, të depozituara në protokollin e Komisionit apo nëpërmjet postës elektronike, si dhe ato gjatë seancës dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

A. VLERËSIMI I PASURISË

20. Pas marrjes së raportit të hollësishëm dhe të arsyetuar të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit nga ILDKPKI-ja, u procedua me hetimin administrativ për vlerësimin e pasurisë së këtij subjekti. Hetimi i kryer nga Komisioni është përqendruar në vërtetësinë e deklarimeve të bëra nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, si dhe burimin e ligjshëm të krijimit të këtyre pasurive.

20.1. Në deklaratën *Vetting* (shtojca 2), të dorëzuar në ILDKPKI në datën 27.1.2017, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar pasuri të luajtshme apo të paluajtshme përveç llogarisë bankare, si vijon:

21. Gjendje e llogarisë⁶ rrjedhëse pranë “Credins Bank” në datën 27.1.2017 në vlerën -234,515.00 lekë. Pjesa takuese: 100%.

21.1. Burimi sipas deklaratës *Vetting*: të ardhurat nga paga si prokurore. *Overdraft* i lidhur më 21.6.2016. Ulje limiti: 5,000 lekë/muaj. Detyrimi i mbetur: 235,000 lekë.

⁵ “41. Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: “Komisioni dhe Kolegji i Apelimit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë KPK-ja gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelimit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse”.

⁶ Subjekti ka dorëzuar dokumentet: nxjerrje llogarie “Credins Bank”; marrëveshje huaje në llogari rrjedhëse, datë 21.6.2016.

Hetimi⁷/analiza ligjore-financiare i/e kryer nga Komisioni lidhur me këtë pasuri

22. Bazuar në shkresën e “Credins Bank” rezulton se subjekti ka llogari në këtë bankë dhe gjendja në datën 27.1.2017 është -234,515.00 lekë. Në këtë llogari depozitohet paga e subjektit.

Overdrafti në “Credins Bank” është çelur me kontratën e nënshkruar në datën 16.2.2011 në shumën fillestare 60,000 lekë, me afat të rinovueshëm 1-vjeçar, me interes 18%. Kësti mujor i shlyerjes 5,000 lekë (për shlyerje principali).

- Në datën 19.5.2011 është rritur limiti i OVD-së në masën + 50,000 lekë.
- Në datën 29.8.2011 është rritur limiti i OVD-së në masën + 65,000 lekë.
- Në datën 23.12.2011 është rritur limiti i OVD-së në masën + 70,000 lekë.
- Në datën 26.6.2013 është rritur limiti i OVD-së në masën + 20,000 lekë.
- Në datën 3.7.2014 është rritur limiti i OVD-së në masën + 90,000 lekë.
- Në datën 21.6.2016 është rritur limiti i OVD-së në masën + 70,000 lekë, me ulje limiti 5,000 lekë/muaj me interes 14%.
- Në datën 28.6.2017 është rritur limiti i OVD-së në masën + 40000 lekë, me afat 12-mujor, me interes 14%, me ulje limiti mujor 5,000 lekë.

Tabela nr. 1

	Viti 2011	Viti 2012	Viti 2013	Viti 2014	Viti 2015	Viti 2016	Viti 2017	Viti 2018
Shuma e OVD-së	-60,000.00	-195,000.00	-140,000.00	-140,000.00	-175,000.00	-200,000.00	-220,000.00	-220,000.00
Shtesa në datën e rinovimit	-185,000.00	0.00	-20,000.00	-90,000.00	-25,000.00	-70,000.00	-40,000.00	-40,000.00
Total OVD	-245,000.00	-195,000.00	-160,000.00	-230,000.00	-200,000.00	-270,000.00	-260,000.00	-260,000.00
Shlyerje OVD	50,000.00	55,000.00	25,000.00	55,000.00	0.00	50,000.00	40,000.00	0.00
Detyrim i mbetur në datën e rinovimit	-195,000.00	-140,000.00	-140,000.00	-175,000.00	-200,000.00	-220,000.00	-220,000.00	-260,000.00
Gjendja OVD më 31 dhjetor	-199,537.00	-138,534.00	-144,974.00	-137,534.00	-78,766.00	-247,293.00	-183,625.00	-208,177.00

22.1. Në përfundim, të dhënat e administruara përputhen me deklarin e subjektit. Subjekti nuk ka pamjaftueshmëri financiare. Nuk rezultojnë dyshime apo paqartësi.

22.2. Komisioni ka administruar dhe analizuar DPV/2018. Në deklaratën e interesave privatë të vitit 2018, subjekti ka deklaruar se *në datën 9.11.2018, me kërkesë të saj, është çelur dëshmia e trashëgimisë nr. ***, datë 9.11.2018, të babait Z.F(i cili ka ndërruar jetë në datën 3.1.2014) në bazë të së cilës trashëgimtare të vetme janë Riselda Fishta dhe I.F(përkatësisht me pjesë të barabarta prej ½ të secilës nga pasuritë e të ndjerit).*

⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 17.9.2020, drejtuar bankave të nivelit të dytë; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 30.12.2020, e “Credins Bank”.

22.2.1. Në përputhje me dëshminë e trashëgimisë datë 9.11.2018, lëshuar nga noter E. B, rezulton që subjekti të ketë përfiturar këto pasuri:

a) Bashkëpronare në ½ pjesë të pasurisë “apartament” me sip. 58 m² në rrugën “M. Gj” pranë ***-së, pallati nr. *, Tiranë, blerë nga i ndjeri Z.F me kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 28.5.2002, në shumën 2,200,000 lekë.

22.2.2. Në përgjigje të pyetësorit standard, subjekti ka vënë në dispozicion:

- i. kopje të vendimit për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore nr. ***, datë 9.11.2018, nga ku rezulton se subjekti ka përfiturar të drejtën e trashëgimisë me ½ pjesë të barabartë të të gjithë pasurisë së trashëgimlënësit, të ndjerit Z.F;
- ii. kopje të kontratës së sipërmarrjes (të padatur) lidhur midis sipërmarrësit Nd. “V. K” dhe babait të saj Z.F, ku përcaktohet se çmimi i apartamentit të porositur (apartament me sip. 58 m² në rrugën “M.Gj”, Tiranë) është 2,200,000 lekë, paguar me këste: kësti i parë në vlerën 2,100,000 lekë paguar në datën e lidhjes së kontratës së sipërmarrjes; kësti i dytë në vlerën 0 (zero) lekë; dhe kësti i tretë në vlerën 100,000 lekë, me afat pagese datën 30.10.2000;
- iii. kopje të kontratës së shitblerjes nr. ***, datë 28.5.2002, sipas të cilës blerësi ka likuiduar totalisht shumën 2,200,000 lekë jashtë zyrës noteriale, përmes mandatpagesës nr.***, datë 3.10.2000 në vlerën 2,100,000 lekë dhe mandatpagesës nr. ***, datë 17.10.2000, në vlerën 100,000 lekë.

22.2.3. Komisioni⁸, gjatë hetimit, ka administruar vërtetim “për vjetërsinë në punë për efekt pensioni” të Drejtorisë së Arkivit Qendror të ISSH-së, nga ku rezulton se babai i subjektit ka pasur marrëdhënie punësimi me punëdhënësit e mëposhtëm:

- Uzina E, Tiranë, me detyrë “tornitor nxënës” për periudhën 31.7.1960 – 15.9.1964;
- NSHN ** Dhjetori Pa, Tiranë, me detyrë “nd.elektracist” për periudhën 29.1.1966 – 1.6.1966;
- Rep. Usht. *** Kukës, me detyrë “ushtar” për periudhën 19.11.1966 – 11.12.1968;
- Nd.Sht.Kom.Elektrik Tiranë, me detyrë “elektracist” për periudhën 8.1.1969 – 31.7.1975;
- Nd. Elek. Ujësjellësi Tiranë, me detyrë “elektracist” për periudhën 1.8.1975 – 30.6.19980;
- Nd.Kom. Elektrike Tiranë, me detyrë “p.shfryt. dhe mont.” për periudhën 1.7.1980 – 5.7.2006.

Në këtë vërtetim pasqyrohet edhe punësimi i nënës së subjektit pranë Nd. Energjetike (Tec) Tiranë, por mungojnë të dhënat për periudhën e punësimit të saj.

22.2.4. Në kushtet kur kjo pasuri: (i) është krijuar kur subjekti ishte 17 vjeç; (ii) është përfiturar me trashëgimi; (iii) është përfiturar nga subjekti pas deklaratës *Vetting*; (iv) si dhe nuk ngrihen dyshime për fshehje pasurie, Komisioni vlerëson të mos thellohet më tej në vlerësimin e saj. Për pasojë, nuk rezultojnë dyshime apo paqartësi.

b) Bashkëpronare në ½ pjesë të depozitës bankare të trashëgimlënësit pranë “Intesa Sanpaolo Bank” hapur nga i ndjeri Z.F në datat 26.3.2008 dhe 20.6.2008. Shuma e përfiturar është 857,799.26 lekë, e cila është tërhequr në datën 14.12.2018 dhe është mbyllur si depozitë.

22.3. Lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie nga babai i saj, në përgjigje të pyetësorit nr. 1, subjekti ka cituar: “...*dua të sqaroj se këto llogari janë çelur nga babai*

⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 10.3.2021, drejtuar ISSH-së; shkresë kthim përgjigjeje, vërtetim nr. *** prot., datë 25.3.2021, e Drejtorisë së Arkivit Qendror ISSH, Dega e Fondit Arkivor të Kontributeve; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 23.3.2021, e ISSH-së, Drejtoria e Burimeve të Informacionit.

i cili ka depozituar kursime familjare gjatë viteve të punës. Unë nuk kam pasur kontribut në këto llogari, pasi në kohën e çeljes së tyre kam qenë në vit të fundit të Fakultetit Juridik dhe nuk kam pasur të ardhura, por edhe vetë mbahesha nga familja... ”.

22.3.1. Nga nxjerrja e llogarisë bankare të babait të subjektit në “Intesa Sanpaolo Bank”, me nr. ***, verifikohet tërheqja e shumës 857,499.38 lekë, me komentin “Riselda Fishta tërheqje ½ e trashëgimisë së të ndjerit Z.F me detaje të veprimit bankar”, sipas deklaratës noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 6.12.2018, të dëshmisë së trashëgimisë ligjore nr. *** rep., nr. *** kol., datë 9.11.2018.

22.3.2. Bazuar në shkresën e “Intesa Sanpaolo Bank” në emër të babait të subjektit Z.V. F, në vitin 2017, rezulton:

- llogari depozite nr. ***, me gjendje 281,776.71 lekë;
- llogari depozite nr. ***, me gjendje 561,825.31 lekë;
- llogari depozite nr. ***, me gjendje 856,000 lekë.

22.3.3. Nga shqyrtimi i dokumentacionit ka rezultuar se:

- i. Në datën 25.3.2002 shtetasi Z.F depoziton në llogari bankare depozitë 6-mujore nr. *** në lekë, shumën 100,000 lekë. Kjo llogari në datën 25.9.2002 rezulton me gjendje 243,538.84 lekë. Në këtë depozitë rezulton të jenë kredituar fonde ndër vite dhe më 31.12.2007 depozita rezulton në balancën 765,136.40 lekë. Kjo depozitë ka pasur rinovime periodike 6- mujore deri më 24.4.2014.
- ii. Në datën 28.5.2002 shtetasi Z.F depoziton në llogari bankare depozitë 6-mujore nr. 00011306, shumën 150,000 lekë. Kjo llogari më 28.11.2002 rezulton me gjendjen 184,784.66 lekë. Në këtë depozitë rezulton të jenë kredituar fonde ndër vite dhe më 31.12.2007 rezulton në balancën 650,875.32 lekë. Kjo depozitë ka pasur rinovime periodike 6-mujore deri më 30.6.2014.
- iii. Në datën 23.7.2014 nga depozitat e mësipërme janë krijuar tri depozita me afat rinovimi 6-mujore, përkatësisht:
 - depozita nr. ***, me datë fillimi 23.7.2014, datë mbarimi 23.1.2015, në shumën 274,094.64 lekë;
 - depozita nr. ***, me datë fillimi 23.7.2014, datë mbarimi 23.1.2015, në shumën 546,216.07 lekë;
 - depozita nr. ***, me datë fillimi 24.10.2014, datë mbarimi 24.4.2015, në shumën 856,000 lekë.

Këto depozita kanë pasur rinovime periodike 6-mujore dhe në datën 29.12.2017 balanca e tyre rezulton të jetë në total në shumën 1,699,602.02 lekë.

iv) Në datën 13.12.2018 këto fonde janë bllokuar nga banka për llogari të dëshmisë së trashëgimisë.

v) Në datën 13.12.2018 gjendja në këtë llogari është 1,715,598.51 lekë.

vi) Në datën 14.12.2018 shtetasja I.F (nëna e subjektit) tërheq sipas deklaratës noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 6.12.2018, dëshmisë së trashëgimisë ligjore nr. *** rep., nr. *** kol., datë 9.11.2018, shumën 857,649.25 lekë.

vii) Në datën 14.12.2018 znj. Riselda Fishta tërheq sipas deklaratës noteriale nr. ***rep., nr. *** kol., datë 6.12.2018, dëshmisë së trashëgimisë ligjore nr. *** rep., nr. *** kol., datë 9.11.2018, shumën 857,649.38 lekë.

22.3.4. Nga analiza e kryer rezulton që origjina e kësaj depozite daton që në vitin 2002. Komisioni, bazuar në argumentimin në pikën 22.2.4., të këtij vendimi, vlerëson të mos thellohet më tej në vlerësimin e kësaj depozite, për pasojë nuk rezultojnë dyshime apo paqartësi.

c) Bashkëpronare me ½ pjesë të shumës së depozituar nga trashëgimlënësi në “Raiffeisen Bank” prej 2,960 USD, prej të cilave subjekti i rivlerësimit përfiton shumën 1,510 USD.

22.4. Bazuar në shkresën e “Raiffeisen Bank” rezulton se babai i subjektit në datën 20.9.2005 depoziton 1,504.59 USD në llogari depozitë, e cila maturohet më 22.9.2006, duke marrë interes 46.53 USD. Kjo depozitë në vitin 2017 rezulton të jetë në vlerën 3,021.75 USD, me interes në vlerën 0.31 USD dhe në vitin 2018 rezulton të jetë në vlerë 3,021.75 USD.

22.4.1. Nga nxjerrja e llogarisë bankare të babait të subjektit në “Raiffeisen Bank”, me nr. ***, verifikohet tërheqja e shumës 1,510 USD “Riselda Fishta tërheq sipas aktit të trashëgimisë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 9.11.2018”. Kjo shumë është tërhequr në datën 21.3.2019.

22.4.2. Komisioni, bazuar në argumentimin në pikën 22.2.4⁹, të këtij vendimi, vlerëson të mos thellohet më tej në vlerësimin e kësaj depozite, për pasojë nuk rezultojnë dyshime apo paqartësi.

23. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar për herë të parë në DPV/2018 se bashkëjeton me shtetasin I.P. Në përgjigje të pyetësorit standard, subjekti sqaron se bashkëjetesa ka filluar në qershor të vitit 2018. Në deklaratën e interesave privatë të vitit 2018, bashkëjetuesi i subjektit të rivlerësimit, I.P, deklaroi:

a) “Apartament” me sipërfaqe 82.6 m², me nr. pasurie ***, e ndodhur në rrugën “M. D”, Linzë, Tiranë, në vlerën 30,000 euro, me kontratën e shitblerjes me kusht kreditimi nr. *** rep., nr. *** kol., datë 20.3.2018.

23.1. Si burime të krijimit të kësaj pasurie, bashkëjetuesi i subjektit deklaroi:

i) kredi në “Union Bank” në vlerën 26,000 euro, sipas kontratës së kredisë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 10.4.2018;

ii) kursime nga paga në vlerën 4,000 euro.

23.2. Nga dokumentacioni i administruar ka rezultuar si më poshtë vijon¹⁰:

- i. Në datën 20.3.2018, me kontratën e shitblerjes me kusht kreditimi nr. *** rep., nr. *** kol., të noteres M.Ç, bashkëjetuesi i subjektit ka blerë apartament me sip. 82.6 m², në Linzë, Tiranë.
- ii. Në përmbajtje të kontratës së shitjes përcaktohet se çmimi i shitjes së pasurisë është 30,000 euro, vlerë e cila do të likuidohet nëpërmjet kredisë bankare.

Bazuar në shkresën nr. ***prot., datë 10.11.2020, të ASHK-së Tiranë rezulton se shtetasi I.P ka në pronësi pasurinë “apartament” me sip. 82.60 m² (pasuri aktive), me nr. ***, z. k. ***, në Linzë, Tiranë. Nga kartela e pasurisë së paluajtshme rezulton se kjo pasuri është bllokuar në favor të “Union Bank” për shumën 37,170 euro në datën 23.4.2018, për garantimin e kredisë bankare hipotekore nr. *** rep., nr. *** kol., datë 10.4.2018.

iii. Burimi i krijimit të pasurisë

Nga dokumentacioni i administruar rezulton se shtetasi I.P ka marrë kredi në “Union Bank” në shumën 26,000 euro, me kontratë kredie bankare hipotekore nr. ***, datë

⁹ Subjekti ka qenë 20 vjeç në momentin e krijimit të kësaj pasurie.

¹⁰ Shkresë nr. *** prot., datë 17.9.2020, drejtuar bankave të nivelit të dytë; shkresë kthim përgjigjeje nr.*** prot., datë 29.9.2020, e “Union Bank”; shkresë nr. *** prot., datë 27.9.2020, dërguar ASHK-së; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 10.11.2020, e ASHK-së.

10.4.2018. Afati i kredisë është 120 muaj. Referuar përmbajtjes së kësaj kontrate kredie rezulton se qëllimi i lëvrimit të saj është “blerje shtëpie sipas kontratës së shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 20.3.2018”.

Bazuar në shkresën e “Union Bank” rezulton se kredia bankare është disbursuar në llogarinë e kredimarrësit I.P në datën 30.4.2018 dhe po në këtë datë shuma e disbursuar është transferuar në llogarinë bankare të noteres M.Ç, me përshkrimin “I.P kalim për blerje prone apartament Tiranë”.

23.3. Në lidhje me diferencën e çmimit të blerjes së pasurisë në shumën 4,000 euro, subjekti i rivlerësimit, në pyetësin nr. 2, ka deklaruar: *“Kursimet e deklaruara prej I. P në shumën prej 4,000 euro rrjedhin nga të ardhurat familjare për periudhën 1.1.2015 – 1.3.2018. Konkretisht këto të ardhura vijnë nga pagat gjatë këtyre viteve të bashkëjetuesit, nënës dhe motrës së tij dhe pensionit të babait”.*

23.4. Lidhur me këtë deklaramin subjekti ka dorëzuar:

- vërtetim nr. *** prot., datë 12.3.2021, lëshuar nga ISSH-ja, Drejtoria Rajonale Lezhë, sipas të cilit shtetasi F.P ka përfituar pension pleqërie me datë fillimi 27.6.2014. Për periudhën 1.1.2017 – 31.12.2017 shuma e përfituar është 245,694 lekë;
- vërtetim nr. *** prot., datë 12.3.2021, lëshuar nga ISSH-ja, Drejtoria Rajonale Lezhë, sipas të cilit shtetasja D.P për periudhën 1.1.2017 – 31.12.2017 ka përfituar si pagë vjetore *neto* shumën 570,536 lekë;
- vërtetim nr. *** prot., datë 17.3.2021, lëshuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, sipas të cilit shtetasi I.P për periudhën 5.5.2015 – 31.12.2020 ka përfituar shumën 2,974,039.00 lekë;
- vërtetim nr. *** prot., datë 12. 3.2021, lëshuar nga ISSH mbi pagën e shtetas M.P, nga ku rezulton se për periudhën 1.1.2017 – mars 2018 ka përfituar pagë *neto* 400,112 lekë.

23.5. Analizë financiare

	Viti 2015	Viti 2016	Viti 2017	Paga janar + shkurt 2018
Të ardhura	1,133,450.00	1,452,265.00	1,804,283.00	316,178.00
Të ardhura I.P	339,869.00	636,218.00	655,624.00	110,888.00
Të ardhurat D.P	547,887.00	567,913.00	570,536.00	95,823.00
Të ardhurat F.P	245,694.00	245,694.00	245,694.00	44,224.00
Të ardhura M.P		2,440.00	332,429.00	65,243.00
Shpenzime	897,104	980,937	1,154,760	164,184
Shpenzime jetike	897,104	940,368	952,216	164,184
Shpenzime TIMS		40,569	202,544	0
Të ardhura <i>neto</i>	236,346	471,328	649,523	151,994
Mundësia për kursime kumulative	236,346	707,674	1,357,197	1,509,191

23.5.1. Nga analiza financiare rezulton se shtetasi I.P dhe familjarët e tij kanë pasur mundësi për të siguruar shumën 4,000 euro.

23.6. Nuk rezultojnë paqartësi në lidhje me këtë deklaramin, që mund të lindin dyshime në disfavor të subjektit.

24. Automjet “Mercedes-Benz” tip “Daimler Chrysler **”, blerë me kontratën e shitblerjes nr. ****, datë 10.4.2017, në vlerën 3,000 euro**

24.1. Burimi i krijimit:

- a) *overdraft* me vlerë 159,000 lekë nga “Raiffeisen Bank”, me datë 16.3.2017;
- b) *overdraft* me vlerë 150,000 lekë i nënës D.P;
- c) kursime nga paga në vlerën 680 euro.

24.2. Nga dokumentacioni i administruar rezulton si më poshtë vijon¹¹ :

- Bazuar në shkresën kthim përgjigjeje nr. ****prot., datë 2.10.2020, nga DPSHTRR-ja rezulton se shtetasi I.P ka në pronësi automjetin me targa AA **** PJ.
- Automjeti tip “Daimler Chrysler”, vit prodhimi 2002, është blerë nga shtetasi I.P me kontratë shitblerjeje automjeti nr. **** rep., nr. **** kol., datë 10.4.2017, lidhur me shitësin P.Gj, në vlerën 3,000 euro.
- Bazuar në dokumentacionin e dërguar nga DPSHTRR-ja rezulton se shtetasi P.Gj e ka blerë këtë automjet në Itali në vlerën 800 euro, sipas faturës së shitjes (përpiluar në Itali) datë 13.3.2017.

24.3. Në lidhje me burimin e krijimit të kësaj pasurie të luajtshme rezulton se:

- i) Bazuar në nxjerrjet e llogarive bankare përcjellë me shkresën “kthim përgjigjeje” të datës 12.10.2020 nga BKT-ja, rezulton se shtetasja D.P në datat 13.2.2017, 6.3.2017 dhe 17.3.2017 ka tërhequr në ATM-në e BKT-së, dega Lezhë, në total shumën 150,000 lekë.
- ii) Bazuar në nxjerrjet e llogarive bankare përcjellë me shkresën kthim përgjigjeje nga “Raiffeisen Bank”, rezulton se shtetasi I.P ka lidhur kontratë OVD-je në datën 16.3.2017, me limit 159,000 lekë dhe në datën 17.03.2021 ka tërhequr shumën 200,000 lekë.

24.4. Analizë financiare për vlerën 680 euro

	Viti 2015	Viti 2016	Datë 31.3.2017
Të ardhura	339,869.00	636,218.00	163,906.00
Të ardhura I.P	339,869.00	636,218.00	163,906.00
Shpenzime	224,276	235,092	59,514
Shpenzime jetike	224,276	235,092	59,514
Shpenzime TIMS		40,569	0
Mundësia për kursime	115,593	401,126	104,392

Nga analiza financiare duket se shtetasi I.P ka pasur mundësi të sigurojë vlerën 680 euro.

24.5. Në rubrikën “Angazhime dhe veprimtari private dhe/ose publike dhe të ardhurat e krijuara prej tyre” në deklaratën Vetting, subjekti ka deklaruar të ardhurat si më poshtë vijon:

24.6. Të ardhurat nga Shkolla e Magjistraturës

¹¹ Shkresë nr. **** prot., datë 17.09.2020, drejtuar bankave të nivelit të dytë; shkresë kthim përgjigjeje nr. **** prot., datë 12.10.2020, e BKT-së; shkresë nr. **** prot., datë 17.9.2020, drejtuar bankave të nivelit të dytë; shkresë kthim përgjigjeje nr. **** prot., datë 8.10.2020, e “Raiffeisen Bank”; shkresë nr. **** prot., datë 17.9.2020, drejtuar DPSHTRR-së; shkresë kthim përgjigjeje nr. **** prot., datë 2.10.2020.

- viti 2008, të ardhura nga bursa në vlerën 127,500 lekë, Shkolla e Magjistraturës;
- viti 2009, të ardhura nga bursa në vlerën 510,000 lekë, Shkolla e Magjistraturës;
- viti 2010, të ardhura nga bursa në vlerën 382,500 lekë, Shkolla e Magjistraturës.

24.6.1. Burimi sipas deklaratës Vetting: të ardhurat nga bursa e Shkollës së Magjistraturës e përfituar si studente me profilin “kandidat për prokuror”.

Bazuar në vërtetimin nr. ***, datë 1.11.2016, lëshuar nga Shkolla e Magjistraturës, rezulton se subjekti ka përfituar bursë si studente pranë kësaj shkolle në periudhën tetor 2008 – tetor 2010, përkatësisht: në vitin 2008 shumën 127,500 lekë; në vitin 2009 shumën 510,000 lekë; dhe në vitin 2010 shumën 382,500 lekë.

Bazuar në shkresën e “Raiffeisen Bank”¹² rezulton se subjektit i kanë kaluar të ardhurat nga bursa nëpërmjet llogarisë bankare nr. ***. Kjo llogari aktualisht është e mbyllur.

24.7. Të ardhurat nga paga si prokurore (në stazh)

- i. Viti 2010, të ardhura të përfituara për periudhën kohore tetor – dhjetor 2010 gjatë ushtrimit të funksionit si prokurore (në stazh) në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë në vlerën 171,533 lekë.
- ii. Të ardhura të përfituara për periudhën kohore janar – nëntor 2011 gjatë ushtrimit të funksionit si prokurore (në stazh) në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë në vlerën 767,099 lekë.

24.7.1. Burimi sipas deklaratës Vetting: të ardhura të përfituara gjatë ushtrimit të funksionit si prokurore (në stazh) në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Bazuar në vërtetimin e datës 25.1.2017, lëshuar nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, rezulton se subjekti ka përfituar pagë si prokurore (në stazh) pranë këtij institucioni për periudhën tetor – dhjetor 2010 në vlerën 171,533 lekë dhe për periudhën janar – nëntor 2011 në vlerën 767,099 lekë.

Bazuar në shkresën e “Credins Bank”¹³ rezulton se subjektit i kanë kaluar të ardhurat nga paga nëpërmjet llogarisë bankare nr. ***, e cila shërben ende si llogari page.

24.8. Të ardhurat nga paga si prokurore

- i. Nëntor – dhjetor 2011, të ardhura si prokurore në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Lezhë, në vlerën 105,846 lekë.
- ii. Janar – dhjetor 2012, të ardhura si prokurore në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Lezhë, në vlerën 873,440 lekë.
- iii. Janar – dhjetor 2013, të ardhura si prokurore në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Lezhë, në vlerën 897,480 lekë.
- iv. Janar – dhjetor 2014, të ardhura si prokurore në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Lezhë, në vlerën 1,106,557 lekë.
- v. Janar – dhjetor 2015, të ardhura si prokurore në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Lezhë, në vlerën 1,090,995 lekë.
- vi. Janar – dhjetor 2016, të ardhura si prokurore në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Lezhë, në vlerën 1,125,055 lekë.

24.8.1. Burimi sipas deklaratës Vetting: të ardhura të përfituara gjatë ushtrimit të funksionit si prokurore në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Lezhë.

¹² Shkresë nr. *** prot., datë 17.9.2020 drejtuar bankave të nivelit të dytë; shkresë “kthim përgjigjeje” nr. *** prot., datë 8.10.2020, e “Raiffeisen Bank”.

¹³ Shkresë nr. *** prot., datë 17.9.2020, drejtuar bankave të nivelit të dytë; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 30.12.2020, e “Credins Bank”.

Bazuar në vërtetimin nr. *** prot., datë 11.1.2017, lëshuar nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Lezhë, rezulton se subjekti ka përfitur pagë si prokurore pranë këtij institucioni në periudhën nëntor 2011 – në vijim.

Bazuar në shkresën e “Credins Bank” rezulton se subjektit i kanë kaluar të ardhurat nga paga nëpërmjet llogarisë bankare nr. ***, e cila shërben ende si llogari page.

Pasi u vlerësua dokumentacioni i administruar, nuk kanë rezultuar mospërputhje, paqartësi apo pasaktësi në deklaram.

Konkluzioni i Komisionit mbi vlerësimin e pasurisë

25. Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti nuk ka në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikojë ligjërisht, si dhe ka deklaruar saktësisht dhe plotësisht në deklaratën *Vetting* pasuritë e saj dhe të personave të lidhur me të, ashtu siç parashikohet në pikën 1 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës. Subjekti ka dorëzuar në kohë deklaratën e pasurisë dhe ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë së tij. Nga hetimi ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit nuk është përpjekur të fshehtë apo të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij. Kjo do të thotë që në rastin e subjektit të rivlerësimit Riselda Fishta nuk vërtetohen shkaqet që Kushtetuta i ka parashikuar të tilla që, nëse vërtetohen, do të zbatoheshin parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit.

Për sa më sipër, trupi gjyqësor vlerëson se subjekti i rivlerësimit, znj. Riselda Fishta, ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të germës “a” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

B. KONTROLI I FIGURËS

26. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, znj. Riselda Fishta, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse ka/ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016.

26.1. Për këtë qëllim, DSIK-ja, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit raportin¹⁴ mbi kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, znj. Riselda Fishta, ku ka konstatuar se: (i) formulari i deklaramit është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë dhe në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 84/2016; (ii) subjekti ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete, si ato të deklaruara në deklaratën për kontrollin e figurës; si dhe (iii) nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar.

26.2. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me pikën 2 të nenit 39 të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës.

26.3. Komisioni kreu hetim¹⁵ të pavarur për kontrollin e figurës dhe integritetin e subjektit të rivlerësimit, znj. Riselda Fishta, përfshirë këtu edhe verifikimin e informacioneve të dërguara rishtazi nga agjencitë ligjzbatuese. Nga hetimi administrativ i kryer nga Komisioni nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve

¹⁴ Deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. ***, datë 6.1.2021, të KDZH-së.

¹⁵ Për më shumë shih dosjen me informacion të klasifikuar të subjektit të rivlerësimit.

të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar apo përfshirjen e tij në veprimtari të kundërligjshme, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

Konkluzion i Komisionit për vlerësimin e kontrollit të figurës

27. Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, znj. Riselda Fishta, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të germës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

28. Në lidhje me këtë kriter, Komisioni u shpreh me vendimin e ndërmjetëm nr. 4, datë 14.7.2021.

28.1. Pas analizimit të detajuar të dosjeve të administruara, qoftë në kuadrin e vlerësimit profesional, qoftë në kuadrin e vlerësimit të figurës, Komisioni konstatoi mangësi profesionale, të cilat mund të plotësoheshin nëpërmjet ndjekjes së Programit të Trajnimit njëvjeçar të Shkollës së Magjistraturës.

28.2. Në përfundim të këtij trajnimi, me shkresën nr. *** prot., datë 1.7.2022, Shkolla e Magjistraturës ka dërguar pranë Komisionit rezultatet e provimit përfundimtar të subjektit, bazuar në pikën 2 të nenit 60 të ligjit nr. 84/2016.

28.3. Bazuar në rezultatet e arritura, të miratuara nga Këshilli Pedagogjik, si dhe Këshilli Drejtues i Shkollës së Magjistraturës, me vendimin nr. ***, datë 27.6.2022, konstatohet se subjekti i rivlerësimit Riselda Fishta ka arritur rezultate të mira, duke i kaluar mangësitë e parashtruara në vendimin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

KONKLUZION PËRFUNDIMTAR

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha shpjegimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, konkludon se subjekti:

- i. arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- ii. arrin nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- iii. bazuar në shkresën e Shkollës së Magjistraturës rezulton se ka përfunduar me sukses programin e trajnimit, duke mënjanuar mangësitë e konstatuara nga Komisioni.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, referuar në nenin 4, pika 2, nenin 58, pika 1, germa “a”, si dhe në nenin 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Riselda Fishta, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe

publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.

3. Ky vendim ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, në datën 14.7.2022.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Lulzim HAMITAJ

Kryesues

Valbona SANXHAKTARI

Anëtare

Genta TAFA (BUNGO)

Relatore

Sekretare gjyqësore

Etmonda Hoxha